



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Vlerësimi i Aplikacionit Tarifor dhe Propozimi për Tarifat e NQ Gjakova  
sh.a. për Sezonin 2021/2022**

Prishtinë, 31/01/2022



## 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të veta ka filluar shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova për sezonin 2021/2022; në këtë aspekt me dt. 02 korrik 2021, NQ Gjakovës i është dërguar shkresa-njoftimi për fillimin e shqyrtimit tarifor për sezonin 2021/2022 dhe “Plani i zbatimit dhe orari”. Në vijim, NQ Gjakovës i është dërguar Kërkesa për të dhëna dhe informata për shqyrtimin tarifor, ku janë specifikuar të dhënat, informatat dhe dokumentet që NQ Termokos duhet të dorëzoj për shqyrtimin tarifor.

NQ Gjakova nuk ka dorëzuar aplikacionin tarifor sipas ‘Orarit dhe Planit të Zbatimit’, por në vazhdimësi ka kërkuar lirimin nga obligimi për dorëzimin e aplikacionit tarifor me arsyetimin se ndërtimi i ngrrohtores së re dhe ndërimi i teknologjisë kanë ndikuar që të kenë vështirësi në planifikimin dhe dorëzimin e të dhënave dhe informatave që kërkohen për shqyrtim tarifor. Lidhur me këtë duhet theksuar se, gjatë periudhës së zhvillimit të projektit të ndërtimit të ngrrohtores së re, në kuadër të projektit ka qenë e angazhuar konsulenca e jashtme për të asistuar NQ Gjakovën, ndër tjera, edhe për përgatitjen e aplikacionit për shqyrtim tarifor. Dhënia e asistencës për këtë komponentë, është shtyrë në vazhdimësi gjatë kohës së zhvillimit të projektit, si për shkaqe objektive të ndërlidhura me pandeminë ashtu edhe për shkak të mos-gatishmërisë së NQ Gjakovës për të pranuar këtë asistencë. Megjithatë pas insistimeve të vazhdueshme të përfaqësuesit të ZRRE-së në Komitetin Drejtues të projektit, konsulenca e angazhuar ka filluar të punoj në këtë drejtim dhe në gusht të vitit 2021 ka përgatitur një version përfundimtarë të aplikacionit tarifor. Ky version final i aplikacionit i është dorëzuar NQ Gjakovës për ta proceduar më tutje tek ZRRE, normalisht pas shqyrtimit nga ana e tyre dhe azhurnimeve apo vërejtjeve eventuale. Me gjithë kërkesat e vazhdueshme nga ZRRE, NQ Gjakova nuk ka dorëzuar aplikacionin e as nuk ka konfirmuar pajtueshmërinë me të dhënat dhe informatat që ka përmbajtur versioni i aplikacionit përgatitur nga konsulenca. Pas shkresës zyrtare të ZRRE-së, NQ Gjakova me dt. 24 dhjetor 2021 ka dorëzuar me e-mail të njëjtin version të aplikacionit të përgatitur dhe dorëzuar nga konsulenca. Për të qenë në pajtim me procedurat rregullative ZRRE ka kërkuar nga NQ Gjakova që ky aplikacion të ri-dorëzohet në formatin e duhur i nënshkruar nga stafi menaxherial përkatës i NQ Gjakovë. Rrjedhimisht NQ Gjakova me dt. 30 dhjetor 2021 ka ri-dorëzuar aplikacionin në formatin e kërkuar nga ZRRE.

Në këtë dokument janë dhënë vlerësimet për përmbajtjen e aplikacionit për tarifa në përgjithësi, si dhe për përmbajtjen e secilit dokument të dërguar në kuadër të aplikacionit. Vlerësimet kanë të bëjë me kompletimin / jo-kompletimin e aplikacionit, duke treguar se cilët dokumente janë dorëzuar dhe cilat do duheshin dorëzuar. Më tutje vlerësimet elaborojnë në përgjithësi dhe japin udhëzime për korrektësinë e dokumenteve që përmban aplikacioni për tarifa, dhe gjithashtu, pas vlerësimit të secilit dokument të dërguar, specifikohen vlerësimet për saktësinë dhe korrektësinë e të dhënave dhe informatave përkatëse.



## 2 Përmbajtja e Aplikacionit për Tarifa

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar nga NQ Gjakova përmban këto dokumente:

- 1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2021-2022:
  - a) Pasqyra A e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;
  - b) Pasqyra B e të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot (shpenzimet);
  - c) Pasqyra C e faturimit dhe arkëtimit – të dhënat dhe informatat për sipërfaqet e ngrohjes, kapacitetet dhe sasi të energjisë termike, faturimin dhe arkëtimin e konsumatorëve;
  - d) Pasqyra D e investimeve – të dhënat dhe informata për investimet kapitale të planifikuara;
  - e) Pasqyra E teknike - të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve (supozimet për kalkulimin e kërkesës reale për ngrohje, prodhimin dhe furnizimin e ngrohjes, dhe sipërfaqja ngrohëse e parashikuar).
- 2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutores për vitin 2020:
  - a) Pasqyra e fitimit / humbjes (Bilanci i suksesit);
  - b) Bilanci i gjendjes;
  - c) Pasqyra e rrjedhjes së parasë; dhe
  - d) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.
- 3) Të dhënat dhe informatat tjera mbështetëse:
  - a) 'Regjistri i aseteve fikse' në 31.12.2020 me zhvlerësimet vjetore të aseteve për vitet 2020 dhe 2021 si përlllogaritjet e zhvlerësimit për vitet pasuese 2022 – 2024;
  - b) Tabela me ndarjen e aseteve të ngrohës së re të alokuara për energji termike (ngrohje), për energji elektrike, dhe të përbashkëta.
  - c) Përlllogaritja e propozuar e zhvlerësimit të aseteve të ngrohës së re.
  - d) Investimet e reja në kuadër të projektit të SECO-s – Agjencioni Zvicerian për bashkëpunim ndërkombëtarë.
  - e) Pasqyra e Fitimit/Humbjes - e planifikuar për periudhën 2021-2022;
  - f) Planifikimet e prodhimit të energjisë termike dhe elektrike, si dhe shpenzimit të lëndës djegëse – biomasës;
  - g) Planifikimi i sipërfaqeve ngrohëse për sezonin 2021-2022;

## 3 Vlerësimi i Përmbajtjes së Aplikacionit Tarifor

Fillimisht duhet thekuar se aplikacioni tarifor nuk përmban të dhënat dhe informatat siç janë specifikuar në 'Kërkesën për të dhëna dhe Informata' të ZRRE-së, ku në mënyrë detale përshkruhen të dhënat, informatat dhe dokumentet mbështetëse që duhet dorëzuar në kuadër të aplikacionit tarifor. Aplikacioni i tarifave i dorëzuar nga NQ Gjakova, sidomos është i mangët në kuptim të mungesës së detajimeve dhe shpjegimeve mbështetëse për pozicionet kryesore të kostove por gjithashtu edhe të dhënave të energjisë; veçanërisht duhet përmendur këtu paraqitjen e aseteve të ngrohës së re me biomasë për të cilat është paraqitur vetëm një kategorizim bazik. Gjithashtu ka mangësi në ofrimin e të dhënave për konsumatorët - kategorizimi i tyre në aktive / pasive – dhe të sipërfaqeve ngrohëse përkatëse, e gjithashtu për nënstacionet termike. Një vërejtje tjetër e përgjithshme ka të bëjë me



strukturimin e të dhënave dhe informatave ku në disa raste është vështirë të identifikohen se cilit dokument i përkasin apo çka në realitet paraqesin.

#### **4 Vlerësimet për kategoritë e kostove sipas të dhënave të dorëzuar në ZRRE**

##### **4.1 Asetet**

Të dhënat për asetet janë paraqitur në Pasqyrën Rregullative 'A', në Regjistrin e Aseteve 31 dhjetor 2020 dhe përlllogaritjet e zhvlerësimit 2021-2024,

##### **Pasqyra 'A' e asetëve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;**

Në pasqyrën 'A' janë paraqitur asetet në vlerën fillestare (kostoja e blerjes gjegjësisht rivlerësimi), është dhënë zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme (vlera neto kontabël). Asetet janë paraqitur të ndara sipas aktiviteteve të licencuara: prodhimi dhe shpërndarja e furnizimi, si dhe asetet e përbashkëta, si në vijim:

- Asetet e Prodhimit: Vlera fillestare: 564,698 €; Zhvlerësimi i akumuluar: 564,698 €; nga ku rezulton vlera e mbetur kontabël: 0 €;
- Asetet e shpërndarjes e furnizimit: Vlera fillestare: 2,289,206 €; zhvlerësimi i akumuluar: 1,783,385 €; vlera e mbetur: 505,821€;
- Asetet mbështetëse: Vlera fillestare: 478,460€; Zhvlerësimi i akumuluar: 401,390€; dhe vlera e mbetur: 77,070€;
- Asetet e përbashkëta: Vlera fillestare: 655,713€; zhvlerësimi i akumuluar: 655,713€; ku rezulton vlera e mbetur 0€;
- Total Asetet: Vlera fillestare: 3,988,077€; Zhvlerësimi i akumuluar: 3,405,186€; Vlera e mbetur kontabël: 582,891€.

##### **Vlerësimi:**

- Nga të dhënat për vlerën e asetëve kuptohet se janë paraqitur vetëm asetet e 'vjetra', d.m.th. nuk janë paraqitur asetet e ngrohtores së re, që është komisionuar në vitin 2021. Duke marrë parasysh që ngrohitorja e re aktualisht është në operim dhe përdoret për prodhimin e energjisë termike për të mundësuar ofrimin e shërbimit të furnizimit me ngrohje, për të cilin përcaktohet tarifat, pasqyra 'A' do duhej të kishte përmbajtur asetet e ngrohtores së re. Lidhur me paraqitjen e asetëve të ngrohtores së re me biomasë, duhet theksuar se këto asete janë paraqitur në një tabelë të veçantë, për të cilin do të ipet një vlerësim i veçantë.
- Nga Pasqyra 'A' vërehet se është paraqitur vetëm vlera e asetëve të rrjetit të shpërndarjes (505,821 €), ndërsa nga krahasimi me regjistrin e asetëve 2020 dhe përlllogaritjen e zhvlerësimit për vitin 2021, rezulton vlera afërsisht e njëjtë e rrjetit prej 505,704€. Po ashtu në këtë pasqyrë është paraqitur një vlerë e vogël e asetëve 'mbështetëse' (77,070 €), e cila, sipas regjistrit të asetëve përmban vlerën e 'ndërtesave' (të vjetra) dhe 'përmirësimit të tokës' (i referohet parcelave ku është ngrohitorja e vjetër).



- Lidhur me rrjetin e shpërndarjes duhet theksuar se, siç jemi në dijeni nga informacionet tjera, pjesa veriore e rrjetit të shpërndarjes është jashtë funksionit, pra nuk është në operim, për shkak të problemeve të shumta teknike dhe dëmtimeve të tubacionit, si dhe për shkak se kanë filluar punimet e rehabilitimit të kësaj pjese në kuadër të projektit të SECO-s. Për këtë, paraqitja vlerës së aseteve që i përkasin segmenteve të rrjetit që nuk janë operacionale dhe në funksion të ofrimit të shërbimit të furnizimit me ngrohje vlerësohet e gabueshme. Gjithashtu paraqitje e gabueshme është edhe paraqita e ndërtesave të vjetra dhe 'përmirësimeve të tokës' që aktualisht nuk përdoren, së paku jo për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ngrohje, që është subjekt i këtij shqyrtimi tarifor.
- Përfundimisht mund të vlerësohet se asetet në Pasqyrën 'A' nuk janë paraqitur në mënyrë korrekte sepse janë paraqitur vetëm asetet e 'vjetra', më konkretisht asetet që i përkasin rrjetit të shpërndarjes, përderisa nuk janë paraqitur asetet e ngrrohtores së re që aktualisht është në operim dhe në funksion të ofrimit të shërbimit të furnizimit me ngrohje.

#### **Regjistri i Aseteve 2020 dhe përlogaritja e zhvlerësimit për periudhën 2021-2024**

Fillimisht duhet përmendur se në këtë regjistër janë paraqitur në mënyrë detale të gjitha asetet e ngrrohtores së vjetër me vlerat e tyre kontabël në datën 31 dhjetor 2020, si dhe përlogaritjet për zhvlerësimin për periudhën 2021-2024. Gjithashtu vlera e aseteve dhe zhvlerësimet përkatëse janë dhënë në formë të përmbledhur në një tabelë shtesë, sipas kategorizimit në vijim:

- Prodhimi ('Përmirësimet e tokës', ndërtesat dhe pajisjet/kaldajat) – vlera kontabël e mbetur në 2021: 77,071€;
- Rrjeti në vlerën e mbetur kontabël 2021: 505,821 €;
- Pajisjet IT dhe inventari i zyrës e zhvlerësuar plotësisht – pra vlera e mbetur kontabël 2021: 0€;

#### **Vlerësim:**

Në këtë regjistër është paraqitur vlera kontabël e aseteve të vjetra në 2020 dhe janë përlogaritur zhvlerësimet për 2021 – 2024, sipas normave të zhvlerësimit të aseteve, duke dhënë vlerën e mbetur kontabël sipas viteve. Nga krahasimet përkatëse të të dhënave, kuptohet se ky regjistër, konkretisht llogaritjet për vitin 2021 (vlera kontabël totale e aseteve: 582,891€), ka shërbyer si bazë për paraqitjen e të dhënave në Pasqyrën 'A'.

#### **Paraqitja e aseteve të ngrrohtores së re me biomase – Projekti i EU-së**

Stabilimentet e Ngrrohtores së re me biomasë përfshijnë 2 njësi të prodhimit vetëm të energjisë termike (HoB) me kapacitet  $2 \times 5.5 \text{ MW}_{\text{TH}} = 11 \text{ MW}_{\text{TH}}$  dhe njësia e bashkëprodhimit të energjisë termike dhe elektrike (CHP) me kapacitet  $4 \text{ MW}_{\text{TH}}$  dhe  $1.12 \text{ MW}_{\text{EL}}$ , janë kryesisht investim i financuar – donacion nga Unioni Evropian.



Në aplikacionin tarifor është paraqitur një ndarje shumë bazike e këtyre asetëve e kategorizuar si në vijim:

- Asetet për prodhimin vetëm të energjisë termike (ngrohjes) – pra 2 njësitë HoB – në vlerë 1,606,081€;
- Asetet për prodhimin e energjisë elektrike (turbina, gjeneratori dhe transformatori) në vlerë 2,308,000 €;
- Asetet e përbashkëta në vlerë totale 7,685,762€:
  - ‘Asetet e përbashkëta të CHP’ – 3,150,684€;
  - Ndërtesat – 1,823,025€; dhe
  - ‘Asetet tjera’ – 2,712,053€.
- Vlera totale e asetëve të ngrohjes së re: 11,599,843 €

Në shtesë është paraqitur edhe alokimi i tyre në asete që i përkasin shërbimit të ngrohjes, ku asetet e përbashkëta janë alokuar mes energjisë elektrike dhe ngrohjes në raportin 50% : 50%; pra asetet e alokuara për ngrohje janë llogaritur:

- Asetet për prodhim vetëm të energjisë termike (ngrohjes): 1,606,081€; dhe
- Asetet e përbashkëta të alokuara për ngrohje:  $0.5 * 7,685,762 = 3,842,881€$ ;
- Vlera totale e asetëve që i përkasin shërbimit të ngrohjes: 5,448,962 €

Më tutje asetet që i përkasin ngrohjes janë kategorizuar në:

- Ndërtesa – 911,512 €; dhe
- ‘Pajisje dhe Instalime’ – 4,537,450 €

#### **Vlerësimi:**

- Siç u përmend më lartë, nuk është dhënë një paraqitje e detajuar e asetëve, që e pamundëson kategorizimin e asetëve sipas kërkesave rregullative në grupe të veçanta për qëllim të përcaktimit të normave të zhvlerësimit; grupimi i asetëve sipas praktikave rregullative si në vijim:
  - Ndërtesa;
  - Stabilimente, pajisje dhe instalime elektro-mekanike;
  - Rrjeti – tubacionet fittingjet dhe pajisjet përbërëse;
  - Pajisjet e TI dhe të zyrës, si dhe pajisjet e sistemeve matëse dhe kontrolluese;
- Një shembull tipik është mos-paraqitja ndaras e segmentit të ri të rrjetit që lidhë ngrohoren e re me rrjetin ekzistues, i cili, mund të supozohet se është kategorizuar në ‘asete tjera’. Po ashtu, nuk janë paraqitur ndaras edhe sistemet matëse dhe kontrolluese të stabilimenteve të ngrohjes së re



re. Siç u theksua më lartë asetet përkatëse kanë norma të ndryshme të zhvlerësimit dhe do duhej paraqitur ndaras.

- Sa i përket alokimit të aseteve në asete që përkasin energjisë termike respektivisht energjisë elektrike, duhet theksuar se nuk janë dhënë detaje dhe shpjegime se në çfarë metodologjie është bazuar ndarja e aseteve të përbashkëta sipas raportit 50%:50%.

## **Investimet e Reja**

### **Pasqyra rregullative 'D' e Investimeve**

Në këtë pasqyrë janë paraqitur investimet totale të reja në vlerën 11,248,962 € - të ndara në: Investimet në vijim ('aktuale'): 9,498,962 € dhe investimet e planifikuara 1.75 mil €. Investimet 'aktuale' janë ndarë në investimet në prodhim, shpërndarje dhe tjera, ndërsa Investimet e planifikuara janë vetëm për shpërndarje.

Në mungesë të shpjegimeve shtesë, mund të supozohet se këto investime i përkasin projektit investiv të EU: ndërtimi i ngrohtores së re me biomasë dhe projektit të SECO-s. Megjithatë, krahasimi i të dhënave respektive me të dhënat për këto projekte investime, tregon mjaft mos-përputhje.

### **Investimet e reja në kuadër të Projektit të SECO-s**

Për investimet e reja janë paraqitur komponentët kryesor të projektit të SECO-s, që aktualisht ka filluar të realizohet me vlerat e para-llogaritura si në vijim:

- Rehabilitimi i rrjetit e nënstacioneve dhe instalimi i matësve të ngrohjes – 2,400,000 € (zëvendësimi i rrjetit 1,6 mil € + nënstacionet dhe matësit 0.8 mil €) ;
- Rehabilitimi i rrjetit të brendshëm dhe instalimeve në Spitalin Rajonal të Gjakovës – 1,000,000 €;
- Kçja e ndërtesave të reja - në vlerë 600,000 €

**Shënim:** Në tabelë gjithashtu janë paraqitur edhe komponentët e asistencës teknike dhe shërbimeve konsulente dhe vlerat monetare respektive.

### **Vlerësimi:**

- Për komponentët kryesorë nuk janë dhënë detaje dhe shpjegime përkatëse, që e vështirëson mjaft kategorizimin për përcaktimin e normave të zhvlerësimit. Një shembull i tillë është për komponentën e kçjes së ndërtesave të reja ku është paraqitur një shumë totale e investimit. Kçja e ndërtesave të reja zakonisht përfshinë segmentin gypor nga tubacioni kryesor gjer tek ndërtesa dhe instalimin e nënstacionit, që normalisht konsiderohen kategori të veçanta të aseteve me norma të ndryshme të zhvlerësimit.
- Në kuadër të këtyre investimeve të reja janë paraqitur edhe rrjeti i brendshëm dhe instalimet e ngrohjes në Spitalin rajonal; këto asete nuk i përkasin NQ Gjakovës dhe rrjedhimisht nuk mund të përfshihen në Bazën e rregulluar të aseteve.



## 4.2 Kostot Operative

### Pasqyra 'B' e të hyrave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot

Në Pasqyrën 'B' janë paraqitur të hyrat dhe shpenzimet operative të parashikuara për periudhën që përfshinë sezonin e ngrohjes 2021-2022.

#### Vlerësimi:

- Në fillim duhet theksuar se kjo Pasqyrë nuk është shoqëruar me detajizimet (shpalosjen) e pozicioneve kryesore të kostove, ashtu siç përcaktohet në Kërkesën e ZRRE-së.
- Të hyrat e planifikuara në vlerë prej 973,156 € janë të parapara nga shitja e ngrohjes dhe janë të njëjta me faturimin e planifikuar në Pasqyrën 'C' për sipërfaqen ngrohëse totale 100,000 m<sup>2</sup>. Në vlerësojmë se ky është një parashikim tejet jo-real, mbi-parashikim tejet i madh, sepse për një sipërfaqe ngrohëse prej 100,000 m<sup>2</sup> as për së afërmi nuk mund të realizohen të hyra prej afër 1mil€. Për ilustrim po përmendim se NQ Termokos për sipërfaqe ngrohëse mbi 1.4 mil m<sup>2</sup> realizon të hyra nga shitja e ngrohjes rreth 7 mil€.
- Nën pozicionin 'Të Ardhurat tjera' nuk është paraqitur subvencioni për lëndën djegëse – Në Buxhetin e Kosovës për vitin 2021, përmes, atëherë, Ministrisë së ekonomisë dhe ambientit, janë ndarë 300,000 €, dhe po ashtu në Buxhetin e vitit 2022 janë të ndara 300,000 €.
- Për koston e lëndës djegëse NQ Gjakova ka paraqitur vlerën prej 477,134 €, dhe nuk është dhënë ndonjë shpjegim për sasinë e lëndës djegëse – biomasës, dhe çmimin njësi. Sipas kontratës për furnizim me biomasë (gdhendla druri) të dt.11.06.2021 janë kontraktuar 3,500 ton biomasë me çmim 99.71€/ton, që rezulton në vlerën totale prej 295,750 €. Mbetet e paqartë ndryshimi prej rreth +180,000 € për koston e lëndës djegëse.
- Një shembull tjetër i paraqitjes së pasaktë të kostove, në këtë rast nën-planifikim është kostoja e personelit; NQ Gjakova ka parashikuar koston totale të personelit prej 125,619 €, përderisa në Pasqyrat financiare 2020 në Raportin e auditorit kjo kosto është 191,224 €.
- Gjithashtu për kostot tjera kryesore nuk janë dhënë detalizimet dhe shpjegimet përkatëse, që e bënë mjaft të vështirë verifikimin e saktësisë dhe korrektësisë së paraqitjes së tyre.

Lidhur me kostot operative, duhet përmendur se në kuadër të aplikacionit është dorëzuar edhe 'Pasqyra e Fitimit / Humbjes – parashikim për sezonin 2021/2022". Siç vërehet nga krahasimi me Pasqyrën rregulative 'B', ka mjaft mos-përputhje të dhënave përkatëse mes këtyre 2 pasqyrave. Për shembull, në këtë pasqyrë, përveç prodhimit të energjisë termike është parashikuar edhe prodhimi i energjisë elektrike, përderisa aktualisht nuk prodhohet energji elektrike për shkak se nuk është vënë në funksion njësia e ko-gjenerimit; rrjedhimisht edhe sasia e lëndës djegëse dhe kostoja janë të ndryshme. Njëjtë, ndryshime të tilla ka, për shembull edhe për koston e personelit, ku në këtë pasqyrë





kostoja totale e personelit është afërsisht 200,000 €, ndërsa në Pasqyrën rregullative 'B' kjo kosto është paraqitur në shumën rreth 125,000 €. Shembujt e lartcekur tregojnë konkretisht jo-konsistencë dhe mungesë të seriozitetit në paraqitjen e të dhënave për të njëjtat pozicione, që shkakton konfuzitet dhe pamundëson konfirmimin e të dhënave.

#### 4.3 Sipërfaqet ngrohëse dhe Bilanci i energjisë termike

Të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe të dhënat e Bilancit si: prodhimi i energjisë termike, humbjet në rrjetin e shpërndarjes, furnizimi etj., janë të ndërlidhura dhe ndikojnë në kostot e ndërmarrjes, e gjithashtu janë, të ashtuquajtur, 'përcaktues të faturimit' që ndikojnë në llogaritjen e tarifave. Këto të dhëna kryesisht janë paraqitur në Pasqyrën 'C' të Faturimit dhe Arkëtimit – të dhënat e parashikuara për sipërfaqen e ngrohjes, faturimin dhe arkëtimin dhe në Pasqyrën 'E' – të dhënat teknike dhe Bilanci i energjisë termike (ngrohjes).

Në Pasqyrën 'C' është parashikuar një sipërfaqe ngrohëse totale prej 100,000 m<sup>2</sup>, e tëra e parashikuar për konsumatorët 'pa matje' – pra faturimi tërësisht i bazuar në sipërfaqen ngrohëse për m<sup>2</sup>. Në këtë sipërfaqe totale në këtë sipërfaqe totale, sipërfaqja e konsumatorëve shtëpiak merr pjesë me 54,600m<sup>2</sup> ndërsa sipërfaqja e konsumatorëve komercial e institucional është parashikuar të jetë 45,400 m<sup>2</sup>.

Për këtë sipërfaqe ngrohëse është planifikuar një faturim prej 973,156 € - për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak shuma prej 681,209 € dhe për ata komercial e institucional 291,947 €; nëse i referohemi ndryshimit enorm mes shumave të planifikuara të faturimit këto 2 kategori të konsumatorëve (që kanë afërsisht sipërfaqe ngrohëse të barabarta), arrihet në përfundim për një planifikim tërësisht të gabueshëm nga ana e NQ Gjakovës.

Në Pasqyrën 'E', përveç sipërfaqeve ngrohëse, është paraqitur të dhënat e parashikuara për prodhimin e energjisë termike, humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe furnizimin me ngrohje.

NQ Gjakova, përveç një tabele me shumë pak të dhëna për planifikimin e rritjes së sipërfaqeve ngrohëse, nuk kanë dorëzuar ndonjë dokument mbështetës ose shpjegime me detajet e këtyre pozicioneve. Lidhur me këtë duhet theksuar se nuk është dorëzuar as Baza e azhurnuar e të dhënave të konsumatorëve që ka qenë kërkesë specifike për shqyrtimin tarifor; kjo Bazë e të dhënave do duhej të ofronte të dhënat për numrin total të konsumatorëve, ndarjen në pasiv dhe aktivë, sipërfaqet ngrohëse respektive, numrin e nënstacione etj., dhe do shërbente për konfirmimin e të dhënave në pasqyrat 'C' dhe 'E'.

#### Vlerësimi

##### - Për sipërfaqet ngrohëse:

- Nga raportimet e mëhershme dhe nga studimet për projektet e lartpërmendura, në sistemin e NQ Gjakovës janë të kyçur afërsisht 200,000 m<sup>2</sup> sipërfaqe ngrohëse, por që për shkak të problemeve të furnizimit gjatë një periudhe të gjatë një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve janë shndërruar në pasiv ose janë shkyçur.



- Duhet përmendur këtu pjesën veriore të rrjetit, që është në gjendje të keqe teknike, dhe si rrjedhojë shumica e konsumatorëve të kyçur në këtë pjesë të rrjetit nuk janë furnizuar me ngrohje. Sidomos kjo është aktuale në këtë sezon, ku për shkak të problemeve të shumta dhe fillimit të punimeve në rehabilitimin e kësaj pjese të rrjetit, konsumatorët në këtë pjesë të rrjetit nuk janë furnizuar fare me ngrohje.
  - Nga sa u tha më lartë, dhe në mungesë të bazës së azhurnuar të të dhënave apo detajeve sqaruese, pamundësohet konfirmimi i saktësisë së planifikimit të sipërfaqeve ngrohëse.
- Për Bilancin e energjisë termike:
- Në fillim duhet potencuar se në hartimin e Bilancit të energjisë termike si pikënisje është 'Energjia e futur nga karburanti', e cila llogaritet nga planifikimet e sasisë së biomases prej 8,460 ton e shumëzuar me vlerën kalorifike 4.2 MWh/ ton. Kur merret parasysh se, siç u përmend më lartë, sasia e specifikuar në kontratën e furnizimit me biomasë është 3,500 ton, atëherë ky fakt që në start e zhvlerëson këtë bilanc si një planifikim jo-real dhe jo i bazuar në të dhënat faktike.

#### 4.4 Përmbledhje e Vlerësimit

Duke ju referuar vlerësimeve të veçanta për secilën nga kategoritë e kostove gjegjësisht 'përcaktuesve të faturimit', mund të konstatohet si në vijim:

- Aplikacioni tarifor i NQ Gjakovës është i pakompletuar dhe nuk përmban të gjitha komponentët siç specifikohet në Rregullën për përcaktimin e çmimeve të energjisë termike dhe në Kërkesën e ZRRE-së për të dhënat dhe informatat për shqyrtimin tarifor. Mungojnë ose janë të mangëta detajimet dhe shpjegimet përcjellëse për pozicionet kryesore të kostove dhe nuk janë dorëzuar dokumente mbështetëse të specifikuara në Kërkesën e ZRRE-së. Po ashtu strukturimi i të dhënave dhe informatave përcjellëse të paraqitura është shumë kaotik dhe pa një renditje logjike.
- Përveç faktit se mungojnë (nuk janë paraqitur) një numër i konsiderueshëm i të dhënave dhe informatave, duhet potencuar se, të dhënat dhe informatat e paraqitura në kuadër të aplikacionit tarifor janë mjaft të pasakta dhe jo-konsistente, në kuptimin që vërehen mos-përputhje të dukshme mes të dhënave për të njëjtin pozicion, të paraqitura në pasqyra ose tabela të ndryshme. Kjo përgjithësisht vlen si për paraqitjen e aseteve, kostove operative ashtu edhe për të dhënat e 'përcaktuesve të faturimit' – sipërfaqet ngrohëse, prodhimin dhe furnizimin e energjisë termike, humbjet e rrjetit, e tjera të ndërlidhura. Kjo pamundëson në masë të madhe konfirmimin saktësisë dhe vërtetësisë së këtyre të dhënave dhe informatave të paraqitura.

Nga sa u tha më lartë, mund të konkludohet se, aplikacioni tarifor i NQ Gjakovës është i mangët / i pakompletuar, me paraqitje jo-korrekte të dhënave dhe me shumë pasaktësi. Një aplikacion i tillë pamundëson përcaktimin e drejtë dhe korrekt të të hyrave të lejuara e rrjedhimisht edhe tarifave të ngrohjes.



Duke marrë parasysh se, të hyrat gjegjësisht tarifat kanë ndikim direkt në konsumatorin, por edhe në qëndrueshmërinë financiare dhe operative të ndërmarrjes, ky aplikacion tarifor nuk mund të merret për bazë për përcaktimin e të hyrave dhe tarifave të NQ Gjakovës.

## 5 Propozimi për përcaktimin e tarifave për sezonin 2021/2022

### 5.1 Sfondi dhe baza ligjore

Duke u bazuar në vlerësimin gjithëpërfshirës të aplikacionit tarifor të NQ Gjakovës (kapitulli '4') e veçanërisht konstatimet në përmbledhjen e vlerësimit (nënkapitulli 4.4), konkludohet se të dhënat e informatat e aplikacionit tarifor nuk mund të përdoren për të përcaktuar të Hyrat e Lejuara dhe tarifat e energjisë termike, sipas Metodologjisë tarifore në fuqi.

Dispozitat relevante rregullative e kanë parashikuar edhe këtë mundësi dhe kanë përcaktuar veprimet lidhur me përcaktimin e tarifave që Rregullatori ka të drejtë të ndërmarrë. Konkretisht, në nenin 4 dhe shtojcën 5 të Rregullës për vendosjen e çmimeve të energjisë termike, ku elaborohet procedura e shqyrtimit tarifor, përcaktohet obligimi i Rregullatorit, që në raste të tilla, të përcaktoj tarifat sipas vlerësimeve të veta dhe bazuar në të dhënat ekzistuese (historike).

Lidhur me këtë duhet theksuar se me ndërtimin e ngrohtores së që është komisionuar në vitin 2021, ka ndërruar plotësisht teknologjia e prodhimit, nga stabilimentet e prodhimit të energjisë termike me mazut në stabilimentet e prodhimit me biomasë dhe një njësi e ko-gjenerimit. Ky ndërrim i teknologjisë ka ndikim domethënës në ndryshimin e strukturës së kostove të ndërmarrjes – si në kostot operative ashtu dhe kostot kapitale, që pamundëson krahasimin e të dhënave historike përkatëse. Po ashtu, të dhënat që i janë dërguar ZRRE-së gjatë viteve (sezoneve) të kaluara janë të pakta, për shkak se gjatë një periudhe shumëvjeçare NQ Gjakova ka operuar me kapacitete prodhuese të limituara dhe rrjedhimisht me furnizim dukshëm të reduktuar, e gjithashtu për shkak se raportimet e NQ Gjakovës në vazhdimësi kanë qenë të mangëta. Për këtë, shumë pak të dhëna historike mund të konsiderohen valide dhe të përdorshme për të përcaktuar tarifat e energjisë termike për sezonin aktual 2021-2022.

Vlen të përmendet se tarifat e aprovuara për sezonet e kaluara (përfshirë edhe sezonin 2020-2021) janë përcaktuar kur ende kanë qenë në operim stabilimentet e vjetra të prodhimit me lëndë djegëse mazut; në tabelën 1 më poshtë tarifat sezonit të kaluar 2020-2021:

**Tabela 1: Tarifat e energjisë termike të NQ Gjakovës për sezonin e kaluar**

TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2020/2021			
<b>A: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE ME MATJE</b>			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.91	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variable)	[€/MWh]	58.76	
<b>B: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE PA MATJE</b>			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.09	0.12
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variable)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.88	1.27
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.97	1.39



## 5.2 Propozimi për tarifën e energjisë termike për sezonin 2021-2022

Nisur nga përgjegjësia ligjore, si dhe nga mos-disponueshmëria dhe jo-validiteti i të dhënave historike të përshkruar më lartë nën 4.1, për propozim të niveleve tarifore i referohemi krahasimit të çmimeve të lëndëve djegëse mazutit dhe biomasës, përmbajtjes energjetike respektive (vlerave kalorifike) të këtyre lëndëve djegëse, si dhe duke konsideruar kostot e kapitalit të ndërlidhura me investimin në ngrohtoren e re.

Rrjedhimisht, nga sa u përshkrua më lartë, propozohet një zbritje mesatare e tarifave për 7%, siç janë paraqitur në tabelën vijuese '2':

**Tabela 2: Tarifën e energjisë termike të NQ Gjakovës për sezonin aktual**

TARIFAT E ENERGISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2021/2022			
<b>A: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE ME MATJE</b>			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.85	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variable)	[€/MWh]	54.65	
<b>B: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE PA MATJE</b>			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.08	0.11
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variable)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.82	1.18
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.90	1.29

Duhet të theksojmë se këto nivele tarifore do të vlejnjë ekskluzivisht vetë për periudhën gjer në përfundim të këtij sezoni 2021-2022. ZRRE pret dhe do të insistoj me ngulm që aplikacioni tarifor i NQ Gjakovës, për shqyrtimin e ardhshëm tarifor për sezonin 2022-2023, të jetë në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregullative, ashtu që të mundësohet një përcaktim meritor dhe i bazuar i të Hyrave të lejuara dhe tarifave.